



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 28.04.2020)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në  
orën 18:00 dhe mbaroi në orën 18:30.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 9. Erjon Muharremaj (anëtar)*
- 10. Marçela Shehu (anëtare)*

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Alban  
Toro.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në Memorandumin e Mirëkuptimit të miratuar me vendimin nr.131, datë 30.03.2020”, për gatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Hartimin e një Plani Veprimesh Lidhur me Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura dhe Rritjen e Efikasitetit në Gjykatën e Lartë.

Mbledhja plenare e datës 28 prill 2020 fillon me prezantimin e pikës së rendit të ditës nga zonja Naureda Llagami, e cila informon mbi takimin online të realizuar nga ana e Komisionit të Përkohshëm për evadimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë dhe përfaqësuesit e USAID-it lidhur me mënyrën e nënshkrimit të këtij Memorandumi.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Medi Bici.

Merr fjalën zoti Medi Bici i cili lexon relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për një ndryshim në Memorandumin e Mirëkuptimit të miratuar me vendimin nr.131, datë 30.03.2020”.

Ndër të tjera, në relacion parashtrohen shkurtimisht të gjitha hapat e ndjekura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor deri më sot, lidhur me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, duke nisur nga:

Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë dhe miratimi në Këshill i Memorandumit të Mirëkuptimit që do të nënshkruhej nga tre palët, Projekti “Drejtësi për të gjithë” (JFA), Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Gjykata e Lartë (GJL);

Diskutimi në mbledhje plenare i shkresës së Presidentit të Republikës mbi ndërprerjen e qëndrimit të mëtejshëm në detyrë të z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë dhe

kryesimin në vijim të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, çështje e cila iu ngarkua Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për trajtimin dhe përgatitjen e akteve përkatëse;

Ndryshimi më tej i Memorandumit nga ana e Projektit “Drejtësi për të gjithë” sa i përket nënshkrimit, me qëllim zgjidhjen e kësaj situatë, ku palët nënshkruese të ishin Projekti “Drejtësi për të gjithë” dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor;

Analizimi i çështjes nga ana e Komisionit të Përkohshëm, ku si përfundim, dy nga anëtarët e Komisionit mendojnë që përpara nënshkrimit të Memorandumit të ndryshuar, duhet që Këshilli të shqyrtojë çështjen e cila ka të bëjë me statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, z.{...}, i cili nuk mund të qëndrojë më në këtë detyrë për shkak se vendi i tij është shpallur i pari nga Këshilli dhe tashmë ky vend vakant është zëvendësuar nga gjyqtarët e rinj nga radhët e juristëve të shquar; ndërsa anëtari tjetër i Komisionit mendon se çështja e nënshkrimit të Memorandumit duhet të trajtohet veç nga çështja e statusit të anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe se nënshkrimi duhet të ishte bërë që pas miratimit të këtij Memorandumi.

Përfundimisht, duke marrë parasysh qëndrimet e anëtarëve z. Toska dhe znj. Ukperaj në seancën plenare të datës 24.04.2020, Komisioni i Përkohshëm i paraqet për shqyrtim seancës plenare propozimet e anëtarit të Komisionit të Përkohshëm të mbetur në pakicë, propozime të ardhura në dy variante:

1. Ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.131, datë 30.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe miratimin e përmbajtjes së Memorandumit të Mirëkuptimit, sipas tekstit të ndryshuar (bashkëlidhur), ku palë nënshkruese të tij do të jenë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Projekti “Drejtësi për të gjithë” i USAID-it;

2. Ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.131, datë 30.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vetëm për sa i përket personave që do të nënshkruajnë Memorandumin, të miratuar nga ky Këshill më datë 30.03.2020, ku si përfaqësues të Gjykatës së Lartë krahas nënkryetarit {...} të jenë edhe gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Pas relatimit të dy varianteve, zoti Bici heq dorë nga propozimi i variantit të dytë, duke i propozuar vetëm variantin e parë Këshillit.

#### **Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen**

Zonja Llagami merr fjalën për të saktësuar që varianti i propozuar nuk vjen vetëm si propozim i Projektit “Drejtësi për të gjithë”, por është nga drejtuesit e USAID-it, pasi Projekti është një nga projektet e USAID-it.

Duke qenë se në mbledhjen e djeshme Këshilli me shumicë votash vendosi shtyrjen e procesit të vendimmarrjes në lidhje me çështjen e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe nisur edhe nga fakti që afati i fundit për nënshkrimin e Memorandumit, vendosur nga Projekti, përfundon të premtën dhe për të mos humbur shansin për të përfituar nga kjo ndihmë e madhe, **zonja Kadi** i bashkohet propozimit të zotit Bici, pra që Komisioni i Përkohshëm të dalë vetëm me propozimin e variantit të parë.

**Zoti Ilir Toska** merr fjalën në vijim për t’u sqaruar sa i përket konstatimit mbi ndryshimet në përmbajtje të Memorandumit, përveç subjekteve që e firmosin atë, pasi detyrimet që më parë kishte Gjykata e Lartë në Memorandum, nuk janë më, duke u futur nën detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Edhe **zonja Ukperaj** është e mendimit që me ikjen e një pale nga Memorandumi, ndryshon edhe përmbajtja e detyrimeve që palët kanë marrë përsipër në Memorandum, ndaj zonja Ukperaj vlerëson që Memorandumi duhet të miratohet edhe një herë si Memorandum i ri. Gjithashtu edhe **zoti Muharremaj** është i mendimit që Këshilli është përpara një propozimi të ri të ardhur nga USAID-i dhe drejtuar Komisionit të Përkohshëm, i cili më tej ia ka përcjellë Këshillit. Sa kohë që ka modifikim të tekstit të dakordësuar herën e parë, atëherë kërkohet miratimi i kësaj marrëveshjeje të re si dhe një tjetër konstatim i bërë nga zoti Muharremaj është fakti i nënshkrimit të Memorandumit jo më nga Projekti “Drejtësi për të gjithë” por nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe kjo gjë duhet të korrigjohet tek vendimi. Anëtarët bien dakord me korrigjimin e palëve nënshkruese në Memorandum.

**Zonja Kadi** shprehet se në thelb Memorandumi nuk ka asnjë ndryshim. Gjithashtu Gjykata e Lartë do bëjë të njëjtat gjëra që do bënte sipas tekstit të mëparshëm. Gjithashtu në përgjigje për zonjën Ukperaj, zonja Kadi mendon që ky nuk është një Memorandum i ri, por nëse nga ana formale konsiderohet që duhet një miratim i ri me tekstin e

ndryshuar, le të miratohet.

*Zoti Bici* merr fjalën në përfundim për të sqaruar se në projektvendimin e paraqitur Këshillit për miratim është cituar që miratimi do të bëhet sipas tekstit të ndryshuar (bashkëlidhur).

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë për një ndryshim në Memorandumin e Mirëkuptimit të miratuar me vendimin nr.131, datë 30.03.2020, bashkë me sugjerimin e pranuar mbi emërtimin e palëve, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.131, datë 30.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe miratimin e përmbajtjes së Memorandumit të Mirëkuptimit, sipas tekstit të ndryshuar (i bashkëlidhur), ku palë nënshkruese të tij do të jenë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID). 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me miratimin e Memorandumit edhe zonja Ann Trice merr fjalën për të falënderuar Këshillin e Lartë Gjyqësor për nismën si dhe Komisionin e Përkohshëm për

orët e gjata të punës.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**